

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR TË VITIT 2008

NËNTOR 2008

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR TË VITIT 2008 NËNTOR 2008

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për periudhën janar – shtator të vitit 2008 rezultoi me një rritje të mjeteve valutore prej 101,4 milionë eurosh. Llogaria korente regjistroi një deficit prej rreth 840 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit regjistruan vlerën 767 milionë euro duke financuar rreth 91 për qind të deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund të përmbliidhen si:

- Rritje e konsiderueshme e shpenzimeve dhe e të ardhurave korente.
- Thellim i mëtejshëm i deficitit tregtar dhe i atij korent.
- Rritje modeste e flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huamarrjes së sektorit shtetëror.
- Rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente të kryera gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2008, vlerësohen në rreth 6,7 miliardë euro duke qenë rreth 10% më të larta se transaksionet e së njëjtës periudhë të një viti më parë. Bilanci i llogarisë korente gjatë nëntë muajve të parë të vitit ka regjistruar një deficit prej rreth 840 milionë eurosh, ose një rritje vjetore prej rreth 60%. Thellimi i deficitit korent ka ardhur si pasojë e rritjes së deficitit tregtar dhe e ngushtimit të bilancit pozitiv të llogarive të shërbimeve dhe të transfertave korente. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime përfaqësojnë pjesën më të madhe të transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Rreth 95% e shpenzimeve korente të kësaj periudhe ka shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndërkohë që rreth 27% e të ardhurave korente ka hyrë në formën e transfertave. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve siguruan përkatësisht 24% dhe 40% të të ardhurave korente.

I. 1. TREGTIA E JASHTME

Shkëmbimet tregtare¹ në mallra të Shqipërisë me botën, gjatë periudhës janar – shtator të vitit 2008 shënuan një vlerë prej rreth 3.3 miliardë eurosh, duke qenë rreth 18% më të larta sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Shpenzimet për importin e mallrave shënuan vlerën 2,547 milionë euro, ndërkohë që të ardhurat nga eksporti i mallrave arritën në 708 milionë euro. Deficiti i tregtisë së mallrave shënoi vlerën 1.8 miliardë euro, duke qenë rreth 16% më i lartë sesa në vitin 2007. Të ardhurat nga eksporti i mallrave kanë mbuluar rreth 28% të importeve, një raport ky i krahasueshëm me atë të vitit të kaluar.

Rritja vjetore e vlerës së importeve të mallrave shënoi 17%, një normë kjo e krahasueshme me atë të vitit të kaluar. Një faktor që ka ndikuar në rritjen e vlerës së importeve ka qenë rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Importi për përpunim aktiv ka shënuar një rritje vjetore prej 7% gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti, ndërkohë që pesha e kësaj kategorie importesh ndaj vlerës së përgjithshme të importeve ishte 12%.

Tabelë 1. Tregtia e jashtme sipas grupmallrave – Klasifikimi SITC

Milionë euro	IMPORTI			EKSPORTI		
	Janar Shtator 2008	Janar Shtator 2007	Ndryshimi vjetor (në %)	Janar Shtator 2008	Janar Shtator 2007	Ndryshimi vjetor (në %)
Ushqime dhe kafshë të gjalla	316.3	259.4	22	21.8	19.3	13
Pije dhe duhan	82.0	68.4	20	2.3	10.0	-77
Materiale të papërpunuara	53.6	52.3	2	87.8	57.6	52
Lëndë djegëse	425.0	314.5	35	71.0	49.0	45
Yndyrna bimore dhe shtazore	39.2	23.1	70	0.2	0.5	-66
Produkte kimike	248.7	212.4	17	7.8	6.5	20
Mallra të përpunuar	603.5	559.8	8	177.0	126.2	40
Makineri dhe pajisje	526.8	448.1	18	28.6	22.9	25
Artikuj të tjerë të përpunuar	251.4	231.9	8	311.0	297.7	4
Mallra të paklasifikuar diku tjetër	--	--	--	--	--	--
Totali	2,546.6	2,169.9	17	707.5	589.4	20

Kontributin kryesor në rritjen e shpenzimeve për importe e ka dhënë rritja importeve të: lëndëve djegëse, makinerive dhe pajisjeve, ushqimeve dhe kafshëve të gjalla dhe mallrave të përpunuar. Vlera e importeve të këtyre kategorive ndaj vlerës së përgjithshme të importeve është rreth 73%. Importet e produkteve minerale, ndër të cilat pjesën më të madhe e zënë importet e lëndëve djegëse minerale, kanë pësuar rritje të ndjeshme prej 35% ndërsa importet e kategorisë “makineri dhe pajisje” janë rritur me 18%.

Rritja e çmimeve të karburanteve ka bërë që vlera e importeve të këtyre të fundit, gjatë vitit 2008, të shënojë një rritje të konsiderueshme vjetore prej rreth 50%. Shpenzimet për karburante gjatë nëntë muajve të parë të vitit ishin rreth 210 milionë euro nga 140 milionë euro, në nëntëmuajorin e parë të vitit 2007. Rritja e vlerës së importeve të karburanteve ka ardhur pothuajse plotësisht për shkak të rritjes së çmimit, ndërkohë që vëllimi fizik i importeve të karburanteve është rritur me vetëm 2% ndaj vitit të kaluar.

Shpërndarja e importeve sipas qëllimit të përdorimit nuk ka pësuar ndryshime të dukshme në krahasim me një vit më parë. Peshën më të madhe në vlerën e përgjithshme të importeve e zënë mallrat e ndërmjetëm, me 55% të totalit të importeve dhe një rritje vjetore prej 23%. Vlera e importeve të mallrave të konsumit ka shënuar një rritje të lehtë prej 6%, ndërkohë që pesha e këtyre importeve ndaj importeve të përgjithshme ka rënë në 31%, nga 34% në vitin 2007. Vlera e importeve të mallrave kapitalë, pavarësisht rritjes vjetore prej rreth 20%, përfaqëson vetëm 14% të vlerës së importeve të përgjithshme.

Tabelë 2. Vlera e importeve sipas kategorive ekonomike – Klasifikimi BEC.

Milionë euro	Janar Shtator 2008	Shpërndarja në % (2008)	Janar Shtator 2007	Shpërndarja në % (2007)	Ndryshimi vjetor në %
Mallrat kapitalë	344.4	14	285.2	13	21
Mallrat e ndërmjetëm	1,412.2	55	1,143.7	53	23
Mallrat e konsumit	774.7	30	730.8	34	6
Mallra të paklasifikuar diku tjetër	15.4	1	10.2	0	51
Totali	2,546.6	100	2,169.9	100	17

Shpërndarja gjeografike e importeve tregon se vendet e Bashkimit Evropian kanë qenë vendet e origjinës së rreth 60% të importeve të përgjithshme gjatë kësaj periudhe. Shkëmbimet tregtare me Italinë dhe Greqinë zënë peshën kryesore duke përfaqësuar respektivisht 43 dhe 25% ndaj importeve nga vendet e Bashkimit Evropian. Ndërkohë, vihet re se importet nga vendet e rajonit kanë pësuar një rënie prej rreth 6%, kryesisht për shkak të rënies së dukshme të importeve nga Serbia. Megjithatë, shpenzimet për mallrat e ardhur nga Maqedonia dhe Kosova janë rritur me respektivisht 27 dhe 10%, duke bërë që pesha e këtyre dy vendeve ndaj tregtisë së zhvilluar me rajonin, të rritet.

Eksportet nga Shqipëria drejt pjesës tjetër të botës, gjatë nëntë muajve të vitit 2008, ishin rreth 20% më të larta në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Eksportet nga industria e përpunimit aktiv, e cila prej vitesh ka përcaktuar profilin dhe përbërjen e eksporteve të vendit, janë rritur me rreth 6%, ndërkohë që të ardhurat nga kjo kategori eksportesh ndaj eksporteve të përgjithshme kanë shënuar nivelin 60%.

Vlera e eksporteve të brendshme ishte rreth 290 milionë euro dhe ka shënuar një rritje të ndjeshme vjetore prej 47%. Kërkesa e tregut të huaj për produktet minerale dhe metalet bazë ka ardhur në rritje, gjë që dëshmohet nga ritmet e larta të rritjes vjetore të vlerës së eksporteve të këtyre mallrave. Vlera e eksporteve të produkteve minerale vendase, të cilat përfaqësojnë rreth 1/2 e eksporteve të brendshme, është rritur me 50% gjatë këtij nëntëmuajori. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë rritja e eksporteve të lëndëve djegëse minerale si edhe të xeherorëve. Gjithashtu, rritje e konsiderueshme është regjistruar edhe në eksportet e metaleve bazë të cilat, gjatë kësaj periudhe, janë dyfishuar dhe përfaqësojnë rreth 30% të eksportit të brendshëm. Rritja në këtë grupmall ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së eksporteve të gizës dhe çelikut, të cilat gjatë kësaj periudhe kanë qenë rreth 7 herë më të larta sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ashtu si importet, edhe eksportet e Shqipërisë, drejtohen për nga vendet e BE-së, të cilat kanë siguruar rreth 80% të të ardhurave të përgjithshme nga eksportet e mallrave gjatë periudhës janar – shtator. Italia dhe Greqia mbeten partnerët tradicionalë edhe në eksportet e vendit, duke tërhequr përkatësisht 61 dhe 9% të eksporteve të përgjithshme. Eksportet drejt vendeve të rajonit kanë shënuar një rritje vjetore prej 30%. Eksportet drejt Kosovës kanë shënuar një rritje prej 46%, duke bërë që Kosova të renditet si partneri më i madh në rajon përsa i përket eksporteve, me rreth 6% të vlerës së përgjithshme të eksporteve dhe rreth 45% të eksporteve në vendet e rajonit.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Vlera e transaksioneve në kategorinë e shërbimeve gjatë periudhës janar – shtator të këtij viti arriti nivelin 2.3 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 10%. Bilanci i llogarisë së shërbimeve për nëntëmujorin regjistroi një deficit prej 10 milionë eurosh, ndërkohë që rritjet vjetore të eksporteve dhe të importeve të shërbimeve kanë qenë rreth normave 9-10%.

Shërbimet e udhëtimit kanë zënë peshën kryesore si në eksportin ashtu edhe në importin e shërbimeve, duke kontribuar me përkatësisht me 78% dhe 72% të vlerave të përgjithshme të shërbimeve. Bilanci neto i shërbimeve të udhëtimit gjatë nëntë muajve të vitit vlerësohet në një suficit prej rreth 60 milionë eurosh, duke paraqitur një përmirësim të lehtë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, e cila regjistroi një suficit prej 54 milionë eurosh. Eksporti i këtyre shërbimeve, gjatë këtij nëntëmujori ka sjellë rreth 900 milionë euro të ardhura dhe një rritje vjetore prej 19%. Këto prurje në valutë kanë qenë rreth 27% më të larta se të ardhurat nga eksporti i mallrave.

Rritja e të ardhurave nga shërbimet e udhëtimit të ofruara në territorin e Shqipërisë, ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së numrit të jorezidentëve që kanë vizituar vendin, rritje kjo prej rreth 36%. Nga të dhënat e vrojtimit për shërbimet e udhëtimit të kryer nga Banka e Shqipërisë, rezulton se rreth 47% e udhëtarëve jorezidentë bëjnë pjesë në kategorinë e emigrantëve ose personave me kombësi shqiptare, që jetojnë në vende të tjera. Përfaqësimi i kategorisë së emigrantëve në grupin e vizitorëve jorezidentë, është veçantërisht i lartë gjatë tremujorit të tretë, periudhë në të cilën një numër i konsiderueshëm emigrantësh vizitojnë Shqipërinë për qëllime personale.

Vlera e shërbimeve të udhëtimit të importuara ose konsumi i rezidentëve jashtë Shqipërisë është vlerësuar në rreth 840 milionë euro, vëllim ky rreth 20% më i lartë krahasuar me periudhën janar-shtator të një viti më parë. Numri i udhëtarëve, i rritur me 24% ka qenë përcaktuesi kryesor i kësaj rritjeje. Rritja në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në vendet e Eurozonës, të cilat janë destinacionet kryesore të udhëtarëve rezidentë, ka ndikuar gjithashtu në rritjen e shpenzimeve mesatare për udhëtar dhe rrjedhimisht, në vlerën e përgjithshme të importeve të shërbimeve të udhëtimit. Deficiti i shërbimeve të transportit është thelluar rreth 2.7 herë, duke reflektuar thellimin e deficitit të tregtisë së mallrave. Kategoria “shërbime të tjera” u mbyll me një suficit prej 62 milionë eurosh, duke u përmirësuar ndjeshëm në harkun kohor të një viti. Sinjale pozitive brenda kësaj kategorie janë vërejtur në shërbimet e komunikacionit.

Ekonomia shqiptare vazhdon të përfitojë të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente dhe njëkohësisht, të paguajë interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në kategorinë e të ardhurave ishte pozitiv edhe gjatë këtij nëntëmujori, dhe vlerësohet në rreth 194 milionë euro me një rritje vjetore prej 13%. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga investimet në formën e investimeve të portofolit dhe prej investimit të

rezervës tonë valutore në institucione jorezidente. Njëkohësisht, flukset dalëse në formën e interesave të borxhit të jashtëm vlerësohen rreth 16 milionë euro me një rritje prej 23% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2007. Të ardhurat nga puna, në krahasim me nëntëmujorin e vitit të kaluar, vlerësohen në rënie me rreth 67% dhe kanë regjistruar shifrën prej 28 milionë eurosh.

Bilanci i transfertave korente gjatë periudhës janar – shtator regjistroi një suficit prej rreth 670 milionë eurosh. Peshën kryesore (rreth 78%) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transferta kanë arritur në 623 milionë euro, duke mbuluar rreth 37% të deficitit të tregtisë së mallrave. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007, këto transferta vlerësohen 13% më të ulëta. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur një zhvendosje e këtyre flukseve valutore nga ato për përdorim korent, në forma të ndryshme investimesh.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Gjatë nëntëmujorit parë të vitit 2008 lëvizjet e kapitalit regjistruan një fluks neto prej rreth 767 milionë eurosh dhe mundësuan financimin e deficitit korent në masën 91%. Përbërësit kryesorë të këtij fluksi janë transfertat kapitale hyrëse prej rreth 58 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 710 milionë eurosh.

Llogaria financiare për nëntëmujorin rezultoi me një bilanc pozitiv, me një rritje më të madhe të detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës (rreth 768 milionë euro) se sa rritja e mjeteve të rezidentëve jashtë (rreth 59 milionë euro). Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës për këtë nëntëmujor ka ardhur si pasojë e flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte, huamarrjes nga jashtë dhe detyrimeve afatshkurtra në sistemin tonë bankar ndaj institucioneve të huaja financiare.

Investimet e huaja direkte neto përgjatë kësaj periudhe vlerësohen në nivelin 380 milionë euro, rreth 2.6% më të larta se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Investimet e huaja në vend prej rreth 354 milionë eurosh, mbeten faktori kryesor në rritjen e detyrimeve financiare. Gjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e fluksit hyrës të investimeve të huaja (rreth 64%) vjen nga investimet në sektorin financiar, kryesisht në bankat tregtare, rritja e investimit të huaj në të cilat është rreth 210 milionë euro ose rreth 2 herë më e madhe se për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vendin e dytë për nga madhësia ndaj fluksit të përgjithshëm të investimeve të huaja gjatë kësaj periudhe ose rreth 16%, e zënë investimet në operacionet hidrokarbure në blloqet e kërkimit dhe vendburimet. Investimet në degën e telekomunikacionit kanë rënë përgjatë nëntëmujorit si rezultat i shpërndarjes së fitimit të kompanive, që operojnë në këtë sektor, në formën e dividendëve.

Një tjetër faktor i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare janë lëvrimet e kredive afatgjata dhe të buta nga jashtë, të cilat kanë shtuar detyrimet nga huamarrja me rreth 254 milionë euro. Këto detyrime vlerësohen të jenë 2.8

herë më të larta kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, si pasojë e rritjes së huamarrjes të sektorit shtetëror.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe interesit vlerësohen në rreth 68 milionë euro, të barazvlefshme me 9.7% të eksportit të mallrave.

Mjetet financiare të ekonomisë shqiptare janë rritur me 59 milionë euro. Rritja ka ardhur kryesisht nga rritja e mjeteve në formën e investimeve të portofolit (10 milionë euro), dhe të investimeve të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar në formën e depozitave (72 milionë euro). Nga ana tjetër, investimet direkte jashtë kanë rënë me 26 milionë euro.

Mjetet e rezervës të Autoritetit Monetar janë rritur me 101.4 milionë euro. Në fund të nëntëmuorit të parë të vitit 2008, këto rezerva regjistruan një nivel rreth 1.6 miliardë euro, të mjaftueshme për të mbuluar 4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 3. Bilanci i pagesave për periudhën janar – shtator të viteve 2007 -2008.

Milionë euro	9M-2007	9M-2008
Llogaria korente	(533.4)	(842.9)
Eksporti i mallrave	589.5	707.5
Importi i mallrave	(2,060.2)	(2,406.0)
Bilanci tregtar	(1,470.8)	(1,698.5)
Shërbimet: kredi	1,056.9	1,154.6
Shërbimet: debi	(1,059.9)	(1,164.6)
Të ardhurat: kredi	213.6	255.8
Të ardhurat: debi	(41.9)	(62.3)
Transferta private pa shpërblim	723.4	656.0
Transferta shtetërore pa shpërblim	45.2	16.0
Llogaria kapitale	65.2	57.9
Llogaria financiare	575.8	709.5
Investime direkte	370.5	380.0
Investime portofoli	(0.7)	(10.0)
Kapitale të tjera*	200.5	344.2
Gabime dhe harresa neto	65.1	176.9
Bilanci i përgjithshëm	172.7	101.4
Rezervat dhe zëra të lidhur me to		
Mjetet e rezervës	(172.7)	(101.4)
Përdorim huash e kredish nga FMN	5.5	(4.7)
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	146.7	121.4
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(25.9)	20.0
*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN		

SHËNIM

¹ Vlerat e llogaritura në tregtinë e mallrave i referohen vlerës c.i.f. për importet dhe f.o.b për eksportet.